Kronikë

I vihet eksploziv ish-magazinave të grumbullimit në Mamurras, lënda plasëse u vu gjatë natës

Një sasi lëndë plasëse i është vendosur ish-magazinave të grumbullimit në Mamurras, e cila fatmirësisht nuk ka shpërthyer. Lënda plasëse është vendosur gjatë natës dhe në vendin e ngjarjes ndodhet policia.

Lajmi i fundit

Rama: Nuk kam lajmërim vdekje për Balikanin e Hapur! Duhet të zhytemi te Procesi i Berlinit, është urë që duhet forcuar

6 Korrik, 13:29

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gjëndëbutka

Redaksia
6 Korrik, 10:44 | **Përditësimi: 6 Korrik, 11:49**

Një sasi lëndë plasëse i është vendosur ish-magazinave të grumbullimit në Mamurras, e cila fatmirësisht nuk ka shpërthyer.

Ngjarja ka ndodhur gjatë mbrëmjes së djeshme, mes 5 - 6 korrikut. Persona ende të paidentifikuar kanë vendosur një sasi të dyshuar si lëndë eksplozivi në këto godina në pronësi të shtetasit Spahi Jahja nga Laçi, të cilat i kishte kthyer në biznes dhe i përdorte si kantina vere.

LEXO EDHE:
Vrasja e policit Xhulio Prela në 2020, Prokuroria e Lezhës kërkon 20 vite burg për Redion Hysën

Lënda plasëse është konstatuar nga roja i objektit prapa godinës së kantinës. Bëhet fjalë për një lëndë plasëse artizanale, bidon amonit malor i përzier me naftë, teksa roja ka konstatuar dhe një kapsollë detonatorë me një fitil të pandezur.

Në vendin e ngjarjes ka mbërritur grupi hetimor për zbardhjen e ngjarjes.

Në përditësim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:37

Eksploziv ish magazinës në Mamurras, policia: Ishte futur në bidon plastik! Godina në pronësi të një 57 vjeçari

Policia jep informacion lidhur me eksplozivin e ndodhur në pjesën e pasme të godinës që dikur ka qenë magazinë grumbullimi në Mamurras.

> *"Në lagjen 'Drita", në Mamurras, në pjesën e pasme të godinës së një biznesi privat në pronësi të shtetasit S. J., 57 vjeç, banues në Laç, është konstatuar një sasi e vogël lënde plasëse artizanale (amonit malor), e futur në një bidon plastik, si dhe në një distancë më tutje, është konstatuar edhe një kapsollë detonatore me fitil zjarrpërcjellës, e paplasur" informoi policia e Lezhës*

Nga shërbimet e specializuara xheniere, u bë heqja dhe largimi i lëndëve plasëse.

Grupi hetimor vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të këtij rasti, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve.

S.G/Shqiptarja.com

A.M./Shqiptarja.com

TAG: Mamurras Lezhë

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
5 vite punë e detyruar në Shqipëri per studentët e Mjekësisë, Jeni dakord?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Plazhe pa siguri në Lezhë, 7-vjeçarja rrezikoi të mbytej! Task-Forca nis monitorimin, paralajmërohen masa deri në heqje license ndaj subjekteve që shkelin ligjin

Elvis Hila

6 Korrik, 10:05

Ura e Zogut 'nën kthetrat e degradimit', aktivistët: Ndërhynë! Projekti për rindërtimin, gatë! Ministria: Puna nis së shpejti

Elvis Hila

5 Korrik, 16:10

Asgjësohen 1541 kanabis në 3 fshatra të Lezhës, s'dihen autorët

5 Korrik, 14:06

Rrezikon të mbytet 7-vjeçarja në Shëngjin! Mungesë e vrojtuesve të plazhit

5 Korrik, 12:41

Lezhë/ Lagjja 'Shehër' me rrugë të paasfaltuara dhe gropa! Banorët: Ka 30 vite kështu, të merren masa

Elvis Hila

4 Korrik, 16:44

Zbulohen dhe asgjësohen parcelat me kanabis, në Kurbin arrestohet kultivuesi, në Lezhë s'dihen autorët

4 Korrik, 13:46



Policia monitoron bregedetin, shpëton turistin italian që rrezikoi të mbytej në Shëngjin! Në Sarandë e Dhërmi bllokon skafe e "Jet Ski" pa leje

1 Korrik, 14:28

Zbulohen 654 bimë kanabis në dy fshatra të Lezhës, kultivuesit nuk dihen ende

30 Qershor, 12:27

Aksidenti në Lezhë, ndërron jetë i moshuari që u transportua në spitalin e Traumës, në gjendje të rëndë djali i tij! Pranga shoferit 19 vjeçar

29 Qershor, 10:08

Aksident në Lezhë, makina me të cilën udhëtonin babë e bir përplaset nga një mjet tjetër! Ndërron jetë i moshuari, pranga shoferit 19 vjeçar (EMRAT)

Elvis Hila

29 Qershor, 08:01

Qeverisja 10 vjeçare e PS, Ndreu: S'mund të pretendohet perfeksion! Me rendin duhet të kishte patur më shumë kujdes! Politika ta lërë policinë të punojë

28 Qershor, 15:27

Sezoni turistik, Pjerin Ndreu në 'Kontrast': Ja oferta e Lezhës për turistët! Siguria prioritet, vitin e kaluar asnjë mbytje

28 Qershor, 15:04

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje